



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2019:124775

Datë: 04.11.2020

Numri i dokumentit: 01245461

C.nr.94/17

GJYKATA THEMELORE PEJË – Departamenti i përgjithshme, Divizioni civil sipas gjyqtarit, Besnik Shala në çështjen juridike jokontestimore sipas propozimit të propozueses H.G nga P rr.”.....” nr... të cilën e përfaqëson av. H.N, dhe kundër propozuesve M.A, Z.G dhe A.A që të tre nga fshati R Komuna e Pejës, me bazë juridike identifikimin, matjen dhe caktimin e mexhës, andaj gjykata në seancën e datës 12.05.2021 mori dhe përpilo këtë:

A K T V E N D I M

KONSIDEROHET i tërhequr propozimi i propozueses H.G dhe kundër kundër propozuesve M.A, Z.G dhe A.A, me bazë juridike identifikimin, matjen dhe caktimin e mexhës.

A r s y e t i m

Propozuesja pranë kësaj gjykate, me dt. 08.06.2017, ka paraqitur propozim për identifikimin, matjen dhe caktimin e mexhës.

Gjykata në këtë çështje juridike jokontestimore ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor për dt. 12.05.2021, me fillim në ora 09:00, dhe ka konstatuar mungesën e të autorizuarit të propozueses së ftuar në mënyrë të rregullt nga ana e gjykatës ku fletë thirrjen për seancë e ka pranuar me datë 14.04.2021 dhe mungesën nuk e ka arsyetuar. Gjithashtu, gjykata ka konstatuar mungesën e kundër propozuesve M.A dhe Agim Ademaj ku fletë thirrjet për seancën e datës 12.05.2021 janë pranuar me datë 16.04.2021 nga Teuta Ademi, gjithashtu gjykata ka konstatuar se në seance nuk është prezentë edhe kundër propozuesja Z. G ku të njëjtën gjykata e ka ftuar por në fletë thirrjen për dorëzim personal ekziston konstatimi i postierit se “ marrësja gjendet jashtë vendit”.

Sipas dispozitës së nenit 12 par 3 të Ligjit të Procedurës Jokontestimore thuhet se propozuesi e ka tërhequr propozimin po qe se nuk vjen në seancën e parë për të cilën është thirrur në mënyrë të rregullt. Kjo rregull nuk vlen në qoftë se ekzistojnë shkaqe të ditura botërisht të cilat e kanë penguar propozuesin që të vijë në seancë.

Nga shkaqet e paraqitura, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, konform Nenit 12 paragrafi 3 të Ligjit të Procedurës Jokontestimore Nr. 03/L-007 (LPJ).

GJYKATA THEMELORE PEJË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHME - DIVIZIONI CIVIL
CN.nr.94/17 dt.12.05.2021

Gj y q t a r i

Besnik Shala

Këshillë juridike:

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 dite, nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmes të kësaj gjykate.